



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2896/ 18 prot.

Datë 19.01.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 78/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.01.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr.1266/2023, datë 05.12.2023, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87708-11-15-2023, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në njësitë e prodhimit” me fond limit 6,030,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 30.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK me NIPT L81904506I dhe adresë: Rruga dytësore “Maminas-Sukth”, km 2

Operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK me NIPT L51512008E dhe adresë rruga “Irfan Tomini” Pallati 59, kati 1, nr. 6, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë me adresë: Rruga “Viktor Eftimiu”, Nr.12, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 05.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1266/2023 ku vendosi:

1. *Të mos pranohet ankesën e operatorit ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87708-11-15-2023, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në njësitë e prodhimit”, me fond limit 6,030,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.*
2. *Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing”, për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
3. *Autoriteti kontraktor të anulohet procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.*
4. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
5. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK.*
6. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing”.*
7. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.*
8. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 57/2 prot., datë 09.01.2024 protokolluar me tonën nr. 2896/15 prot., datë 11.01.2024 autoriteti kontraktor njofton se e ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 1266/2023 datë 05.12.2023 duke anuluar procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87708-11-15-2023, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në njësitë e prodhimit” me fond limit 6,030,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 30.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

### **II**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

## **Arsyeton:**

II.1. Me shkresën nr. 57/2 prot., datë 09.01.2024 protokolluar me tonën nr. 2896/15 prot., datë 11.01.2024 autoriteti kontraktor njofton se e ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 1266/2023 datë 05.12.2023 duke anuluar procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87708-11-15-2023, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në njësitë e prodhimit” me fond limit 6,030,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 30.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

II.2. Nga informacioni i shkresës së mësipërme si dhe nga verifikimet në (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit edhe në sistemin e prokurimit elektronik por autoriteti kontraktor nuk i ka bashkëlidhur shkresës dokumentet e reja të tenderit të procedurës së prokurimit që do të rishpallë.

II.3. Sa më lart, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë nuk e ka zbatuar vendimin nr. 1266/2023 datë 05.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87708-11-15-2023, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në njësitë e prodhimit” me fond limit 6,030,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 30.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë pasi nuk i ka bashkëlidhur shkresës dokumentet e reja të tenderit të procedurës së prokurimit që do të rishpallë.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87708-11-15-2023, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në njësitë e prodhimit” me fond limit 6,030,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 30.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.
  2. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të dërgojë në KPP dokumentet e reja të procedurës së prokurimit që do të rishpallë të cilat duhet të jenë në përputhje me konstatimet e shprehura në vendimin nr. 1266/2023 datë 05.12.2023 të KPP-së.
  3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

